



**VENDIM**

**Nr. 6 Datë 16.01.2012**

**PËR  
MODIFIKIMIN E LIÇENSËS PËR NDËRTIMIN, INSTALIMIN  
DHE SHFRYTËZIMIN E CENTRALIT ELEKTRIK SI DHE  
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE ME SERI NPM06K, NR.  
41, LESHUAR ME VENDIM TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË  
ERE-S NR. 83, DT 27.11.2006 PËR SHOQËRINË ENERGO – SAS  
SH.P.K**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, pikat 2.3 dhe 2.4 e “Liçencës për Prodhimin e Energjisë Elektrike”, si dhe neneve 13, 14, 15 pikat 1 dhe 2 gërma “b”, dhe pikat 3 dhe 4, të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 16.01.2012, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Energo - SAS” sh.p.k për ndryshimin e liçencës Nr. 41, Seria NPM06K, për ndërtimin, instalimin dhe shfrytëzimin e centralit elektrik si dhe prodhimin të energjisë elektrike, lëshuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 83, datë 27.11.2006 dhe informacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

**Konstatoi se:**

Aplikimi i shoqërisë "Energo - SAS" sh.p.k, plotëson kërkesat e “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, si më poshtë:

- **Neni 15, pika 4, gërma “a”** : Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e liçencës.
- **Neni 15, pika 4, gërma “b”** : Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të liçensuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim liçensë.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të miratojë modifikimin e liçensës me Nr. 41, Seria NPM06K, të shoqërisë “Energo - SAS” sh.p.k, “Për ndërtimin, instalimin dhe shfrytëzimin e centralit elektrik si dhe prodhimit të energjisë elektrike”, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 83, datë 27.11.2006.
2. Fuqia e instaluar e Hec-it “Sasaj” nga 7 MW bëhet 8.6 MW.
3. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.